

Në kuadër të Ditës Botërore të Shëndetit, Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Infermierisë, NJVKSH Gjirokastrë dhe studentë nga degë të ndryshme, organizuan një aktivitet informues, edukues dhe promovues mbi rëndësinë e shëndetit dhe kujdesit shëndetësor.

Ky aktivitet kishte për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e kujdesit shëndetësor, promovimin e sjellje të favorshme për shëndetin dhe ofrimin e këshillimeve profesionale nga specialistë të fushës. Pjesëmarrësit patën mundësinë të informohen mbi tema të ndryshme që lidhen me mirëqenien dhe parandalimin e sëmundjeve, nëpërmjet bashkëbisedimeve me profesionistë të shëndetësisë.

